



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2532, datë 22.12.2014

Për

“Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.12. 2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre”.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Pika 10 e nenit 5, shkronja g) dhe gj) të nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 68, dhe neni 69 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*), i ndryshuar;

3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr.2512, datë 06.11.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”.
5. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni përkatës;
- Propozimi i hartuar nga grupi i punës
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Dokumentacioni për “Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz per aplikimet TRA-ECS” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- përfundimet e këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz per aplikimet TRA-ECS”;
- propozimin e AKEP për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin 2500-2690 për aplikimet TRA-ECS, Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr.2512, datë 06.11.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz per aplikimet TRA-ECS”.

V E N D O S:

1. Të miratojë **përfundimin e këshillimit publik** “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, dhe të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit, si dhe qëndrimin e AKEP për çështjet e ngritura sipas dokumentit bashkëlidhur;
 2. Të miratojë propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave në brezat 2500-2690 MHz, për aplikimet TRA-ECS”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____

Komentet e pjesëmarrësve në këshillimin publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave

2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ESC”


Në zbatim të shkronjës g) dhe gj) të nenit 8, të nenit 65, të nenit 68, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it nr.2512, datë 06.11.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ESC”, AKEP kreu një këshillim publik me palët e interesuara.

Në përfundim të këtij këshillimi publik, në AKEP u depozituan komentet nga palët e interesuara si më poshtë:

- 1- Operator 2, shkresa nr.1956/5 date 10.12.2014,
- 2- Operator 3, shkresa 1956/3 date 09.12.2014,
- 3- Operator 1, shkresa 1956/4 date 10.12.2014 dhe

Më poshtë paraqiten komentet e të interesuarve dhe qëndrimi përkatës i AKEP.

AKEP kishte propozuar ndarjen e mëposhtme të spektrit:



1- Për pyetjen 1 të AKEP:

Bazuar ne dokumentat e mesiperme, raporte te CEPT dhe eksperiencat e vendeve te tjera ne administrimin e ketij brezi, 2500-2690 MHz, AKEP propozon qe:

a) Brezat 2500 – 2570 MHz i ciftuar me 2620 – 2690 MHz do te alokohen per menyren e operimit FDD ku brezi me i ulet duhet te jete i alokuar per transmetuesin e levizhem brenda brezit me te ulet te frekuencave dhe transmetuesi baze brenda brezit te siperm ku blloqet e alokuara te frekuencave do te jene shumefisha te 5 MHz.

b) Brezi 2570 – 2620 MHz do te alokohet ose per menyren e operimit TDD ose FDD ku blloqet e alokuara te frekuencave do te jene shumefisha te 5MHz.

A jeni dakort me ndarjen e propozuar nga AKEP?

Operator 1 eshte dakort me kete ndarje te propozuar nga AKEP.

Operator 2 mbeshtet ndarjen e propozuar te spektrit ne brezin 2600 MHz. Te pakten, ajo garanton minimumin e madhesis se te bllokut prej 5 MHz, qe eshte e detyrueshme per perdorimin e spektrit per LTE dhe lejon perdorimin e te dyja menyrave te operimit, FDD dhe TDD, si dhe te teknologjive dhe zgjidhjeve te lidhura me te dhe te bazuara ne te, edhe ne nje periudhe afat-gjate.

Operator 3 shprehet se Ligji 9918/2008 parashikon se nje nga qellimet rregullatore thelbesore te veprimtarise se AKEP eshte administrimi i spektrit te radio frekuencave per te garantuar eficence ne perdorim. Ndaj Operator 3 gjykon se AKEP duhet te mbeshtese adaptimin e plote te udhezimeve te standarteve 3GPP per sa i takon ketij brezi te spektrit. Ne keto kushte Operator 3 sugjeron ndarjen e meposhtme persa i takon FDD dhe TDD:

FDD			TDD	
Band	UL Range (MHz)	DL Range (MHz)	Band	UL/DL Range (MHz)
1	1920 – 1980	2110 – 2170	33	1900 – 1920
2	1850 – 1910	1930 – 1990	34	2010 – 2025
3	1710 – 1785	1805 – 1880	35	1850 – 1910
...	36	1930 – 1990
7	2500 – 2570	2620 – 2690	37	1910 – 1930
8	880 – 915	925 – 960	38	2570 – 2620
...	39	1880 – 1920
13	777 – 787	746 – 756	40	2300 – 2400
...		
20	832 – 862	791 – 821		
...		
24	1626.5 – 1660.5	1525 – 1559		

Eshte Lehtesisht e evidentueshme se brezi 2570-2620 eshte i paracaktuar ne bandat 38 TDD dhe per rrjedhoje pengon pershtatjen e sherbimeve FDD ne kete segment. Nga pikeveshtrimi teknik Operator 3 ju ben me dije se miksimi (kombinimi) i FDD me TDD eshte shume kompleks persa i takon bandave ndarese (guard band) qe ruajne nga interferencat midis sistemeve te ndryshem (lutemi ti referoheni standartit 3GPP TS36 300).

Qendrimi i AKEP:

Te interesuarit kane mbeshtetur propozimin e AKEP per ndarjen, ndersa sugjerojne qe brezi 2570-2620 MHz te perdoret vetem per menyren e operimit TDD dhe jo miksi FDD/TDD sugjerim te cilin AKEP do e marre ne konsiderate.

2- Per pyetjen 2 te AKEP:

AKEP mendon qe sasia e spektrit per te drejte perdorimi te jete 2x5 MHz per brezin e ciftuar dhe 5 MHz per brezin e paciftuar. Ky propozim behet per mundesine teknike te shfrytezimit dhe per te krijuar mundesine qe cdo i interesuar per perdorimin e ketij spektri te jete pjese e gares pamvaresisht nga kapacitetet e tij. Dmth do te jene 14 te drejta 2x5 MHz ne spektrin e ciftuar dhe 10 te drejta 5 MHz ne spektrin e paciftuar.

A jeni dakort me këtë propozim te AKEP?

Operator 1: shpreh dakortesine e tij lidhur me propozimin e AKEP.

Operator 2: Nuk eshte kunder ndarjes se propozuar te te drejtave ne 2x5 MHz per spektrin e ciftuar dhe 5 MHz per spektrin e paciftuar. Por, duke pasur parasysh sasine e spektrit, Operator 2 do te preferonte ndarjen ne blloqe spektri prej te pakten 10 MHz. Propozimi bazohet ne kushtet aktuale te tregut, ku ka vetem 4 operatore celulare dhe kerkesa per 2600 MHz nuk eshte shume e larte. Nga eksperienca e vendeve te tjera, perdorimi optimal i LTE ne brezin 2600 MHz do te kerkonte blloqe te panderprera minimalisht prej 20 MHz dhe operatoret celulare do te donin t'a merrnin nje sasi te tille. Rritja e bllokut minimal nga 5 MHz ne 10 MHz do t'a thjeshtonte proceduren e tenderit (persa i perket raundeve te mundshem) dhe do te evitonte fragmentimin e spektrit te marre, gje qe mund coje ne nevojte per rishperndarje. Operator 2 mendon se do te kete konkurrence te mjaftueshme edhe me blloqe minimale prej 10 MHz, duke qene se do te jene 7 blloqe ne FDD dhe 5 blloqe ne TDD per kerkesen e ulet qe pritet per nje brez, sic eshte 2600 MHz, qe nuk eshte ai i preferuari per LTE, madje edhe ne rang European.

Operator 3: Gjykon se per te garantuar zbatimin e Ligjit 9918/2008 dhe perdorimin eficient te spektrit, AKEP duhet te marre parasysh nevojat proporcionale per spekter per te garantuar ofrimin e sherbimit perkates dhe cilesine e tij, nevoja te cilat nuk jane te njejta per te gjithe operatoret.

Bazuar ne Vendimin e Komisionit European 2008/477/EC te dates 13 Qershor 2008 mbi harmonizimin e spektrit 2500-2690 per sisteme tokesore qe ofrojne sherbimi te komunikimit elektronik ne EU, blloqet e spektrit te alokuar duhet te jene shumefisha te 5 MHz. Brenda spektrit 2500-2690 MHz, hapësira dupleks per veprimtari FDD do te jete 120 MHz me stacionet fundore te transmetimit (up link) te lokalizuara ne pjesen e poshtme te spektrit duke filluar nga 2500 MHz (dhe perhapur deri ne nje limit maksimal prej 2570 MHz), nderkohe qe stacionet baze te transmetimit (down link) te vendosura ne pjesen e sipërme te brezit duke filluar nga 2620 MHz. Nen-brezi 2570-2620 MHz mund te perdoret per TDD ose menyra te tjera perdorimi. Jashte nen-brezi 2570-2620 perdorimi i tij mund te vendoset ne nivel kombetar dhe Operator 3 sugjeron te jete ne pjese te barabarta midis pjeses se sipërme qe fillon nga 2690 (dhe zgjeruar ne zbritje) dhe pjeses se poshtme qe fillon nga 2570 (duke u zgjeruar ne zbritje).

Persa i takon perdorimit te blloqeve me 5 MHz Operator 3 konfirmon se kjo eshte teknikisht e zbatueshme, por megjithate duhet theksuar se per Operator 3 dhe

operatore te tjere ne menyre qe te lancohen sherbime te reja ne teknologjine dhe rrjetin LTE udhezimet perkatese tregojne qe eshte e domosdoshme qe te kene mundesi te marrin te pakten 10 MHz ne FDD. Nje brez spektri prej vetem 5MHz nuk mundeson nje performance cilesore ne kuptimin e throughput, ndryshe nga sherbimet e 3G/HSPA+. Kjo per arsye te blloqeve te limituara te burimeve te LTE pergjate transmetimit te kanaleve FDD brenda nje brezi prej 5MHz.

Tabela ne vijim, marre nga literatura koherente mbi shfrytezimin e LTE1, tregon se maksimumi i gjerise se brezit qe ofrohet nepermjet nje kanali LTE 5 MHz ne FDD (rasti 2x2 MIMO & 64QAM) eshte i ngjashem me ate qe ofrohet nga teknologjia 3G/HSPA+ qe operon me nje konfigurim DC-HSPA prej 42 Mbps, cka aktualisht zoterohet nga te 3 operoret ne Shqiperi. Per rrjedhoje ne kushtet e disponimit te nje brezi vetem 5 MHz ne LTE sherbimi nuk ofron dicka te shtuar per pajtimtaret fundore krahasuar me cka ata marrin per momentin.

Table 9.3 Downlink peak bit rates with transport block size considered (Mbps)

Resource blocks		1.4MHz	3.0MHz	5.0MHz	10MHz	15MHz	20MHz
Modulation and coding	MIMO usage	6	15	25	50	75	100
QPSK	Single stream	0.9	2.3	4.0	8.0	11.8	15.8
16QAM	Single stream	1.8	4.3	7.7	15.3	22.9	30.6
64QAM	Single stream	4.4	6.5	18.3	36.7	55.1	75.4
64QAM	2x2 MIMO	8.8	8.6	36.7	73.7	110.1	149.8

Per gjitha sa me lart Operator 3 sugjeron se AKEP duhet te ndaje autorizimet ne blloqe nga 10 MHz ne brezin FDD, ne vend te 5 MHz cka passjell nje shfrytezim me eficient te spektrit dhe vizion te qarte te perdorimit te brezit 2.6 Ghz per teknologjine LTE. Brezi TDD duhet te kete ne fillim dhe ne fund 5 MHz si brez ndares, nderkohe qe pjesa e mbetur te ndahet ne blloqe nga 10 MHz. Sidoqofte, nese AKEP vendos te vijoje me ndarjen e autorizimeve ne blloqe 2x5 MHz, atehere ai duhet te garantoje medoemos qe blloqet e dhena te jene ne vazhdimesi (contiguous) per arsyet me siper cituar.

Qendrimi i AKEP:

Sipermarresit ne pergjithesi jane dakort me propozimin e AKEP per ndarjen ne blloqe 5 MHz, propozimin per ndarjen ne blloqe prej 10 MHz ne FDD e ka parashikuar ne menyren e paraqitjes se ofertave ku maksimumi eshte 10 MHz per cdo raund vleresimi.

3- Per pyetjen 3 te AKEP:

AKEP per te marre nje vlere reale nga dhenia ne perdorim e ketij spektri mendon qe cmimi te permbaje dy elemente, ate te vleres se perafert dhe ate lineare bazuar edhe ne eksperiencon e deritanishme. Keshtu nje fitues i te drejtave te perdorimit do te kete mundesine te marre ne perdorim spekter sipas koston individuale dhe asaj kolektive. Spektri qe mendohet te jepet ne perdorim ne raundin e pare te vleresimit do te kete koston kolektive, pasi dhe sasia e spektrit qe

mund ti alokohet nje fituesi do te jete e kufizuar. Spektri qe do te mbetet i pa alokuar ne raundin e pare do te jepet ne raundet e tjera te vleresimit dhe kjo ben qe vlera e marre ne keto raunde te jete lineare.

Operator 1: propozon qe brezi 2x10 MHz te jepet pa pagese dhe per pjeset e tjera te aplikohet propozimi i AKEP.

Operator 2: Shpjegimet e dhena nuk jane te mjaftueshme per t'iu pergjigjur kesaj pyetjeje. Nuk eshte e qarte, se si funksionojne mekanizmat e alokimit dhe nga cfare elementesh perbehet cmimi. Termat vlere e perafert dhe lineare si dhe kosto kolektive nuk jane terma standarte qe perdoren ne tendera ne Europe.

Ne e kuptojme se skemen e propozuar ne kete menyre: Propozimi eshte nje tender me shume raunde, ku ne raundin e pare dhe te dyte i jepen ofertuesit(ve) me shumen me te larte maksimalisht 2x10 MHz, ndersa ne raundin e trete dhe ate ne vijim ofertuesit(ve) me shumen me te larte i alokohen 2x20 MHz. Ne secilin raund behet perzgjedhja e ofertave dhe perzgjidhen 2 ofertat me te larta (nga raundi 3 e ne vijim perzgjidhen 4 ofertat me te larta).

Operator 2 eshte dakort me propozimin, por do te deshironte te specifikonte se rezervat prej 2x10 MHz apo limitet prej 2x20 MHz u japin operatoreve celulare me te vegjel nje mundesi me te mire per te marre spekter te mjaftueshem.

AKEP nuk duhet te habitet nese skema çon ne nje shperndarje te pabarabarte te spektrit ndermjet te gjithe operatoreve celulare.

Operator 3: Gjykon qe ne percaktimin e cmimit AKEP duhet ti referohet praktikave me te mira te BE, qofte ne metodologjine e percaktimit te cmimit dhe qofte ne vleren monetare te tij. Vendosja e cmimit te duhur eshte teper e rendesishme per tarifimin e spektrit, per te ndikuar ne permiresimin e caktimit eficient te spektrit: cmimi mbi nivelin e cmimit te tregut do te reduktonte eficencen ne dhenien e spektrit te perdorur.

Spektri i radio frekuencave eshte nje burim natyror i fundem, me nje vlere te larte per shkak te perdorimit per qellime ekonomike dhe tregtare ne sherbimet e komunikimeve elektronike. Ne lidhje me sa me siper, spektri i radio frekuencave ka nje vlere ekonomike te matshme te lidhur me shume faktore, ndermjet te tjerash, kerkesa ne rritje per sherbime celulare me brez te gjere, kategorite e sherbimeve per te cilat do te perdoret, kerkesa per spekter nga operoret e tjere celulare.

Operator 3 gjykon se AKEP ne percaktimin e cmimit duhet te perdore nje benchmark te caktuar per te percaktuar cmimin e pershtatshem per rezervimin e spektrit. Cmimi per rezervimin e spektrit duhet te caktohet nga AKEP duke mbajtur parasysh vleren e tregut.

Eksperienca tregon se autoritetet percaktojne shpesh nje cmim fillestar ne ankandet per spekter duke synuar arritjen e nje ose me shume objektiveve si me poshte:

- Te pengoje ofertuesit qe ofrojne vlera te vogla duke caktuar nje cmim fillestar i cili

pengon ofertuesit jo serioze te marrin pjese ne tender, duke mundesuar qe procesi i tenderit te mbyllet me shpejt (dhe me nje kosto me te ulet);

- Te siguroje qe cmimi perfundimtar i ofertes do te mbuloje se paku kostot e administrimit dhe procesin e dhenies ne perdorim te spektrit;
- Te garantoje se vlera sociale e perftuar nga dhenia per perdorim e spektrit ne nje periudhe te mevonshme do te reflektohet ne cmimin perfundimtar te ofertes (p.sh. te siguroje qe spektri te mos jepet momentalisht, nese vlera sociale e ruajtjes se spektrit per dhenie te mevonshme eshte me e madhe se sa vlera private e perftuar nga dhenia e spektrit ne kete moment); dhe
- Te kufizojte nxitjet per marrveshje te fshehta ndermjet ofertuesve potenciale.

Ne shumicen e rasteve, rregullatoret zgjedhin te perdorin benchmarke (metoda krahasimore) si baze per te percaktuar nje cmim te pershtatshem fillestar. Ky mund te jete rasti kur rregullatoret nuk kane nje model per te matur vleren e spektrit ose ku kostot administrative ne lidhje me tenderin jane te paqarta. Ne zgjedhjen e benchmark-ut, rregullatori mund te zgjedhe ndermjet dy opsioneve:

- Ose te vendose cmimin fillestar sipas benchmark-ut te vendeve te tjera; ose
- Te vendose cmimin final te ankandit sipas benchmark-ut te vendeve te tjera.

Sidoqofte, me zgjedhjen e skenarit te dyte rregullatoret duhet te pershtasin cmimin e benchmarkut per te konvertuar vlerat finale te spektrit ne cmim fillestar.

Shuma minimale qe duhet te paguaje nje ofertues per nje license edhe nese nuk ka konkurrence, varet nga cmimi fillestar i caktuar per ankandin dhe tarifat vjetore pergjate kohezgjatjes se licenses. Operator 3 gjykon se nuk duhet te caktohet nje cmim minimal aq i larte sa qe te rrezikojte te "mbyse" ofertat. Me qendrimin tone per caktimin e cmimit minimal ne fillimisht synojme te vendosim nje nivel minimal te pershtatshem duke perdorur benchmarke te pershtatshem dhe me pas te konsiderojme se cila eshte menyra me e mire per te "copezuar" ate ne nje pagese paraprake ne cmimin fillestar (i pagueshem pas procesit te ankandit) dhe nje serf pagesash te vazhdueshme (si per shembull tarifa vjetore per perdorimin e spektrit). Operator 3 gjykon se cmimi reference qe ne kemi perllogaritur si te arsyeshem dhe referuar ne pergjigje te pyetjes 5, ploteson me se miri keto kushte.

Qendrimi i AKEP:

AKEP ne perllogaritjen e cmimit do te vleresojte propozimet e paraqitura nga sipermarresit ne kete keshillim, eksperiencat e meparshme, eksperiencat e rajonit etj.

4- Per pyetjen 4 te AKEP:

AKEP mendon se sasia e spektrit qe do te kene te drejte te marrin ne raundin e pare te vleresimit fituesit te jete e kufizuar jo me shume se 2x10 MHz (dy te drejta perdorimi 2x5 MHz). Po keshtu ne raundin e dyte te vleresimit jo me shume se 2x10 MHz. Ne raundin e trete te vleresimit sasia maksimale e spektrit qe mund te marrin ofertuesit ne perdorim te jete 2x20 MHz e me tej deri ne dhenien ne perdorim te gjithe spektrit. Te gjithe raundet e vleresimit do te jene brenda te njejtës procedure tenderi.

Operator 1: sic eshte shprehur ne pergjigje te pyetjes 3, kerkon qe ne raundin e pare brezi 2x10 MHz te jepet pa pagese. Per pjeset e tjera, Operator 1 eshte dakort me ndarjet e propozuara nga AKEP.

Operator 2: Sic edhe komentuar ne pergjigjet e mesiperme, Operator 2 e konsideron kete propozim te AKEP teper te komplikuar dhe jo realist per nivelin e pritshem te kerkeses per spekter. Rritja e blloqeve minimale ne 2x10 MHz do t'a thjeshtonte proceduren ne 2 raunde, sic argumentuar ne pergjigjen per Pyetjen 2.

Operator 3: Gjykon se struktura e prezantuar e ofertimit dhe raundet perkatese eshte kopmleke dhe nuk ofron qartesi te plote per vleren e seciles oferte ne cdo faze ofertimi. Ne kete kuptim dokumenti ka nevojë per me shume qartesi, perfshire ketu rregullat tavan per spektrin TDD , cka duhet qartësuar - per shembull Operator 3 sugjeron qe mund te jene 2 blloqe nga 10 MHz TDD. Ne vijim te pergjigjes tone ndaj pyetjes 2 Operator 3 sugjeron qe operatoret te mund te ofrojne oferten e tyre ne tender per te drejta perdorimi 2x10 MHz secila, ose alternativisht blloqe te vazhdueshme prej 2x5 MHz. Per sa i takon procedures qe duhet zbatuar, lutemi ti referoheni pergjigjes tone te detajuar ne pyetjen 13.

Qendrimi i AKEP:

AKEP do te marre ne konsiderate propozimet e sipermarresve ne fazen e pergatitjes se dokumentave te tenderit si dhe do te qartësoje menyren e paraqitjes se ofertave dhe ate te vlersimit.

5- Per pyetjen 5 te AKEP

Bazuar ne ndarjen e paraqitur ne dokumentin e keshillimit publik cila eshte vlera qe jeni gati te paguani per te drejte perdorimi 2x5 MHz?

Operator 1: kerkon qe te drejtat e perdorimi ne kete brez te pakten per 2x10 MHz pa pagese. Per pjesen tjeter te procedohet sipas propozimit te AKEP, por gjithsesi sipas raportit te cilesuar ne pyetjen 6 (pra 3-5 here me pak se konsiderimet lidhur me brezat e tjere te frekuencave).

Operator 2: Gjykon qe tregu celular shqiptar nuk eshte gati per 2.6 GHz, keshtu qe, shitja e ketij brezi para vitit 2016 do te ishte e parakoheshme dhe rrjedhimisht do te

çonte ne te ardhura me te uleta. Vlera aktuale e brezit 2.6 GHz per OPERATOR 2 eshte shume e ulet dhe shume poshte mesatareve Europiane te rregulluara sipas PBB-ve. Sidoqofte, Operator 2 beson fort se vlera e spektrit prej 2.6 GHz do te rritet ne vitet ne vijim. Si hap i pare, do te lancohet LTE ne brezin 1800 MHz dhe do te behet shtrirja ne te gjitha vendin. Ne nje faze te dyte, brezat 2.6 GHz do te shtohen ne zonat me hotspote (akses ne internet) per performance me te mire me t'u zhvilluar baza e klienteve LTE.

Sapo penetrimi i aparateve LTE te kete arritur ne nivele te rendesishme dhe pozicionet ekzistuese kufizojne eksperiencen e klienteve, vlera mund te llogaritet me mesataret e rregulluara te PBB-se (GDP) te shitjeve te spektrit europian ne 5 vitet e fundit, e cila arriti 0,01 €/ MHz/popullates. Kjo perkthehet ne 1.2 milione € per spekter te vazhdueshem 2x20 MHz. Per nje perdorim efikas nevojiten breza frekuencash 2x20 MHz ne spekter te vazhdueshem (si ne brezin 1800 MHz).

Te drejtat e perdorimit 2x5 MHz dhe 2x10 MHz do te kete nje vlere te limituar per Operator 2 pavaresisht nga koha e shitjes. Te drejtat e perdorimit 2x15 MHz deri ne 2x20 do te jene me vlere sapo lancimi te rrise eksperiencen e klienteve LTE.

Operator 3: Gjykon qe cmimi qe duhet vendosur si reference duhet te jete ne segmentin midis €650 mije - €1 milion per bllok 2x5MHz spektri te brezit 2600 MHz. Ne perlllogaritjen e tij kemi marre ne konsiderate dhe cmimin e percaktuar per brezin 1800 MHz ne vleren 3.1 milione Euro per 2X6 Mhz si dhe tenderat e kryer ne vendet e rajonit,.

Tabela ne vijim tregon vlerat dhe raportin midis cmimeve te spektrit 2600 MHz dhe 1800 MHz vend pas vendi dhe gjithashtu tregon impaktin ne cmimin e spektrit nese aplikojme ne ekuacion dhe vleren prej 3.1 milion Euro per 2X6 MHz te spektrit 1800 MHz qe eshte vendosur si cmim reference nga AKEP ne tenderin e dates 2 Mars 2015.

Vendi	Data e ankandit	Cmim/njesi (€/MHz/Pop)		Raporti i cmimit (2600/1800)	Cmimi i rrjedhur per 2600 (€m)
		1800	2600		
Gjermani	Maj-10	0.025	0.022	89%	2.29
Portugali	Nentor-11	0.037	0.028	76%	1.97
Rep.Ceke	Nentor-13	0.049	0.024	50%	1.29
Rumani	Shtator-12	0.047	0.018	37%	0.97
Greqi	Nentor-11	0.190	0.044	23%	0.59
Itali	Shtator-11	0.237	0.054	23%	0.58
Rep.Ceke	Nentor-13	0.049	0.024	50%	1.29
Rumani	Shtator-12	0.047	0.018	37%	0.97
Greqi	Nentor-11	0.190	0.044	23%	0.59
Itali	Shtator-11	0.237	0.054	23%	0.58

Persa i takon TDD sugjerojme cmimin si me poshte:

Vendi	Data e tenderit	Cmim per njesi (€/MHz/Pop)			Raporti i cmimit (2600TDD/FDD)	Cmimi per 2600TDD (€m)
		1800	2600FDD	2600TDD		
Germany	May-10	0.025	0.022	0.023	102%	
Portugal	Nov-11	0.037	0.028	0.011	39%	
CZ	Nov-13	0.049	0.024			
Romania	Sep-12	0.047	0.018			
Greece	Nov-11	0.190	0.044	0.014	32%	
Italy	Sep-11	0.237	0.054			
Rekomandohet		€3.1m			33%	€225-350k

Qëndrimi i AKEP:

AKEP per llogaritjen e vleres qe do te propozoje per cmimin do te marre ne konsiderate propozimet e te gjitha sipermarresve pjesemarres ne kete keshillim.

6- Per pyetjen 6 te AKEP

Cili është raporti qe duhet te kete ne vlere ky brez krahasuar me brezat 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz?

Operator 1: propozon se, per shkak te vleres se larte te investimit qe kerkon implementimi i kesaj teknologjie vlere te jete 3 deri 5 here me pak se brezat e tjere. Gjithashu theksojme se kjo frekuence duke qene afer "freeband" 2.4 GHz, bande e cila perdoret edhe ne rastin e mbulimit me Wifi, argumenton kerkesen tone per te dhene te pakten 2x10 MHz pa pagese.

Operator 2: Brezat nen 1 GHz kane nje vlere me te larte se brezat mbi 1 GHz. Vlora rrjedh nga rrezja me e madhe e nje frekuence me te vogel. Ne kete menyre, si tendence, sa me i larte brezi, aq me e vogel vlere ekonomike e tij. Duke qene se cdo treg eshte i ndryshem ne varesi te madhesis se nje vendi, pjeses dhe pasurise se popullsisë, kerkesat per mbulim me sherbim dhe faktore te tjere, nuk ekziston nje rregull i drejtperdrejte lidhur me keto vlere.

Ne Shqiperi, 2.6 GHz do te jete me vlere ne qytetet e medha dhe qendrat ekonomike. Brezi i frekuencave 1800 MHz per LTE & 2.1 GHz per UMTS do t'i sherbeje te nejtave zonave, por do te mbuloje gjithashtu edhe zonat periferike dhe qytetet me te vogla.

Operator 3: shprehet se nje perlllogaritje krahasimore e raportit mes cmimeve per njesi te brezave 1800 dhe 2600 MHz ne vendet e rajonit e konvertuar ne vlere numerike

mund te gjendet ne pergjigjen e pyetjes 5 me siper.

Per te arritur ne kete rezultat, vlera e spektrit duhet pare nga pikeveshtrimi teknik dhe me pas nga raporti i investimit dhe kthimit te tij. Ne aspektin teknik spektri 2600 MHz ofron hapësire mbulimi shume te kufizuar per shkak te karakteristikave te tij thelbesore fizike te shperhapjes. Per rrjedhoje duhet zbatuar nje raport kostoje proporcional perkundrejt spektrit te bandave te ulta te cilat mundesojne nje raport me te mire kostosh dhe efikasiteti. Kjo ndodh sepse fare cilesive te shperhapjes se valeve radio ne brezin e ulet operatoret munden te reduktojne stacionet fizike te rrjetit radio e per rrjedhoje ulin shpenzimet operacionale dhe mundesojne ofrimin e sherbimit ne treg brenda nje kohe me te shkurter.

Nga pikeveshtrimi i planifikimit te rrjetit (dhe ketu i referohemi kostove kapitale CAPEX) per te garantuar mbulim ne nje zone te caktuar Operator 3 i duhet te parashikojte 5 here me shume stacione LTE nese rrjeti do te mundesohet nepermjet spektrit 2600 MHz, krahasuar kjo me ofrimin e sherbimit nepermjet brezave me te ulet frekuencash si psh 800 MHz, ne varesi te parashikimeve te planifikimit te qelizave transmetuese (detajet e planifikimit te buxhetit per rrjetin radio te LTE jane te domosdoshme per percaktimin e sakte te raportit).

Kuptohet qe ekzistojne dhe nje sere faktoresh te tjere per te percaktuar raportin final te koston qe dalin pertej argumentave teknike. Me poshte ne kemi marre nje shembull nga nje studim i Ofcom2 i cili ka marre ne konsiderate nje sere faktoresh per te arritur nje benchmark me parametrin "GBP per MHz per capital" per breza te ndryshem spektri dhe ofertues te ndryshem ne tregun e UK, thjesht per te dhene ketu nje indicie te pergjithshme.

	800MHz	1800MHz	2.6GHz paired	2.6GHz unpaired
Small bidder	£0.253-£0.434	£0.146-£0.219	£0.080-£0.121	£0.011-£0.059
Large bidder	£0.460-£0.714	£0.146-£0.219	£0.087-£0.121	£0.011-£0.059

Qëndrimi i AKEP:

AKEP do te ruaje raportet ne vlere te brezave te frekuencave te aplikuar deri tani, ato te propozuara ne kete keshillim nga sipermarresit dhe ato te aplikuar ne vende te tjera te rajonit.

7- Per pyetjen 7 te AKEP

Kur mendoni se eshte koha me e pershtatshme qe AKEP te hape proceduren e dhenies ne perdorim te ketij brezi?

Operator 1: mendon se duhet te jepet e drejta e perdorimit ne kete brez ne

te njejten kohe me brezin 800 MHz ose pas saj.

Operator 2: Ne baze te fazes aktuale te zhvillimit te tregut, kryesisht nga kendveshtrimi teknologjik, Operator 2 mendon se eshte shume heret per dhenien ne perdorim te spektrit ne brezin 2600MHz. Duke marre ne konsiderate procedurat e tjera ne vazhdim per dhenien ne perdorim te spektrit ne brezat 2100MHz dhe 1800MHz, koha e duhur per dhenien ne perdorim te spektrit ne brezin 2600MHz duhet te jete nga viti 2017 ose viti 2018 ne vazhdim. Nga njera ane, kjo gje do t'i lejoje Operatoret celulare te testojne kerkesat e mundshme te tregut ne baze te aplikimit te LTE1800 nga nje perqasje me reale drejt LTE2600, ndersa nga ana tjetere, ajo do te pershtase me mire investimin e kerkuar ne spekter me aftesite investuese te operatoreve celulare. Pergendrimi i shume investimeve te mundshme ne te njejten kohe, mund te rezultojne ne tejkalimin e aftesive te operatoreve celulare dhe te rrezikoje deshtimin e procesit te tenderit.

Operator 3: kerkon qe hapja e tenderit per brezin 2600 MHz te jete paralelisht me spektrin 1800 MHz, pra ne 2 Mars 2015. Vetem ne kete menyre operoret e interesuarper ofrimin e sherbimeve dhe rrjetit LTE kane mundesi te kombinojne sasine e spektrit ne keto breza qofte per nga teknologjia dhe nga cmimi i tyre ne funksion te rrjetit LTE.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP do te hape proceduren e dhenies ne perdorim te ketij brezi me perfundimin e ketij keshillimi ne perputhje me percaktimet ligjore dhe rregullatore te fushes se komunikimeve elektronike.

8- Per pyetjen 8 te AKEP

A mund te perputhen ne kohe dhenia ne perdorim e brezave te lire 1800 MHz me dhenien ne perdorim te brezave ne 2.6 GHz?

Operator 1: mendon se radha e dhenies ne perdorim te brezave te lire duhet te jete: 1800 MHz dhe 800 MHz ne fillim, dhe pastaj 2600 MHz. Ose te jepen te tre brezat ne te njejten kohe. Kjo argumentohet edhe me faktin qe 2.6 GHz do te sherbeje thjesht per permiresimin e sherbimit "indoor" dhe ne zonat urbane me densitet te larte te trafikut data.

Operator 2: Sic u shprehem edhe ne pyetjen e mesiperme, Operator 2 sugjeron qe te shmanget dhenia ne perdorim e kombinuar e brezit 1800MHz me 2600MHz, duke gene se eshte shume heret per dhenien e 2600MHz per perdorim per LTE. LTE2600 nuk mund te konsiderohet per mbulim urban apo ne mbare vendin, si LTE1800, por kryesisht per zonat me hotspot. Ne kushtet kur nuk jane aplikuar dhe shfrytezuar ende as kapacitetet LTE1800, eshte shume shpejt per te konsideruar perdorimin e

LTE2600 ne nje periudhe afatshkurter dhe afatmesme.

Operator 3: mbeshtet plotesisht sugjerimin e AKEP qe dhenia e brezit 2600 MHz te perkoje me dhenien e brezit 1800 MHz dhe per kete arsye keto breza spektrale te perfshihen brenda te njejtës procedure tenderi. Kjo zgjidhje gjykojme se eshte me optimalja e mundshme pasi u jep mundesine operatoreve te kene vizibilitet te plote ne kohen e tenderit mbi teresine e spektrit qe do te ofrohet per te shfrytezuar nga teknologjia LTE nga te dy brezat. Kjo ndihmon ne menyre thelbesore qe operatoret te ndertojne strategjine e tyre qartazi per shtrirjen e rrjetit LTE ne breza te ndryshem dhe zbatimin e e teknikave te reja per agregimin e kanaleve (carrier aggregation) duke afruar keshtu industrine e komunikimeve elektronike ne Shqiperi prane standarteve te aplikuar ne BE dhe me gjere. Shembuj konkrete vijne nga Italia, ku disa operatore e kane disponuar tashme ne treg komercialisht Carrier aggregation, me shpjatesi deri ne 225 Mbps ose edhe me teper, ne varesi te set- up teknik me pajisjet fundore te konsumatoreve. E njejta aplikohet edhe ne Spain, Germany dhe gjithashtu ne UK.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP do te beje te gjitha perpjekjet qe ne kete proces te beje zgjidhje qe kenaqin interesat e sa me shume paleve te perfshira dhe ne perputhje me politikat e sektorit te komunikimeve elektronike.

9- Per pyetjen 9 te AKEP

Ne se do te rezultoni fitues i nje te drejte perdorimi cili do te jete qellimi i perdorimit te tij?

Operator 1: Qellimi i perdorimit te kesaj te drejte per Operator 1 do te jete ofrimi i sherbimit me shpejtesi te larte bazuar ne teknologjine LTE ne ambientet e brendshme te godinave dhe ne zonat me perqendrim te larte.

Operator 2: Planifikimi aktual i spektrit per OPERATOR 2 nuk eshte bazuar ne ndonje kerkese specifike per 2.6GHz, por nese behet i disponueshem ne nje faze te mevonshme, me nje çmim te ulet, ne mund ta perdorim ate per kapacitet ne zonat e dendura urbane, qendrat tregtare, zonat me hotspote, etj. Ku kerkesa per sherbime te dhenash do te jete me e larte. Kapacitetet e penetrimit te mbulimit ne ambiente te brendshme dhe mbulim te gjere ne brezat me frekuenca te larte, si 2.6 GHz, jane shume te limituara ne krahasim me breza te tere spektri si 1800MHz apo 800MHz, duke kufizuar keshtu perdorimin e gjere ne mbare vendin.

Operator 3: Ne rast se shpallet fitues Operator 3 synon shfrytezimin e ketij spektri per zbatimin e LTE bazuar ne 3GPP per FDD dhe LTE bazuar ne 3GPP per TDD bazuar versionet ekzistuese te 3GPP dhe ato qe priten te publikohen se shpejti. Gjithashtu ky brez mund te shfrytezohet per transmetim backhaul per

stacionet radio MBB ne varesi te disa kushteve specifike.

10- Per pyetjen 10 te AKEP

Ne se do te rezultoni fitues i nje te drejte perdorimi, cila eshte teknologjia qe do te aplikoni per ndertimin e rrjetit te aksesit?

Operator 1: do te aplikojë për ndertimin e rrjetit të aksesit bazuar në modulimin FDD/TDD.

Operator 2: Për sa i përket teknologjive për t'u përdorur në rrjetin e aksesit, Operator 2 do të përdorë teknologjinë LTE në rrjetin e aksesit në spektrin 2600MHz. Ajo mund të krijojë një shtresë të vecantë mbi shtresat e tjera të spektrit LTE si 1800MHz apo 800MHz dhe në varesi të kërkesës për më shumë kapacitete për ofrimin e performancës së kërkuar në shërbimet që kanë lidhje me të dhënat.

Operator 3: Referojuni përgjigjes së pyetjes 9 më sipër.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP do të konsiderojë propozimet për teknologjitë që do të aplikohen duke aplikuar neutralitetin teknologjik në këto breza.

11- Per pyetjen 11 te AKEP

Kur mendoni se do ishte koha më e përshtatshme për heqjen e kufizimeve teknologjike për brezat në përdorim nga sipërmarrësit duke përfshirë GSM dhe UMTS?

Operator 1: Mendon se heqja e kufizimeve teknologjike për GSM dhe UMTS për brezat në përdorim duhet të jetë e menjehershme, e njëjta gjë edhe për brezat e lirë që planifikohen të shpërndahen.

Operator 2: mbështet dhe ka shprehur edhe më parë qëndrimin e saj për aplikimin e neutralitetit teknologjik duke hequr kufizimet teknologjike për të gjithë brezat aktualisht në përdorim nga operatorët celularë. Por, duke marrë në konsideratë situatën aktuale të spektrit të alokuar dhe përdorimin e tij nga operatorët celularë, koha e përshtatshme do të jetë atëherë kur të gjithë operatorët të zotërojnë spektrin e lirë të kërkuar për të ndërtuar rrjetet dhe të jenë në gjendje të konkurrojnë ndërshterisht, duke ofruar shërbime nëpërmjet teknologjive si LTE. Duke pasur parasysh që sasia e përdorimit të brezave në përdorim nga operatorët celularë është shumë e ndryshme, çdo heqje e kufizimeve teknologjike pa siguruar më parë zotërimin e spektrit të lirë, do të deformatë situatën në treg nëpërmjet nderhyrjes/politikes së autoritetit rregullator, duke krijuar kështu avantazhe konkurruese të pandershme për

disa nga operatoret celulare. Dhe kjo gje nuk do te pranohet nga OPERATOR 2 pasi kjo shkaterron parimet e ekonomise se tregut.

Operator 3: Shprehet dakord ne parim me propozimin per te ndryshuar kushtet aktuale te autorizimeve individuale ne brezat 900/1800 MHz, per te akomoduar teknologjite e reja ne keto frekuenca (UMTS/LTE). Me ndryshimin e legjislacionit per komunikimet elektronike, Ligji 9918/2008 parashikon parimin e neutralitetit teknologjik, duke iu dhene mundesine operatoreve ekzistues te perdorin spektrin per teknologjite e tjera, pervec atyre per te cilin ju eshte dhene spektri fillimisht. Sidoqofte per te garantuar sigurine e investimeve Operator 3 i kerkon AKEP qe te mundesoje neutralitetin teknologjik vetem pasi te jene perfunduar tenderat per spektrin 1800 MHz dhe 2600 MHz dhe te jete realizuar gjithashtu rishperndarja e spektrit (reshuffling).

Qëndrimi i AKEP:

AKEP do te beje te gjitha perpjekjet qe te beje zgjidhje qe kenaqin interesat e sa me shume paleve te perfshira ne keto procese dhe ne perputhje me politikat e sektorit te komunikimeve elektronike.

12- Per pyetjen 12 te AKEP

A mendoni se heqja e kufizimeve teknologjike duhet bere ne te njejten kohe me rishperndarjen e spektrit ne perdorim nga sipermarresit me qellim rritjen e efektivitetit te shfrytezimit apo ne ndonje kohe tjeter?

Operator 1: eshte dakort qe heqja e kufizimeve teknologjike duhet te behet ne te njejten kohe me rishperndarjen e spektrit, ose te hiqet menjehere.

Operator 2: mbeshtet ne parim si heqjen e kufizimeve teknologjike ashtu edhe rishperndarjen e brezave aktuale me qellim krijimin e blloqeve te vazhdueshme te spektrit. Por, Operator 2 kerkon qe perpara implementimin te tyre, i cili mund te jete madje edhe ne te njejten kohe, AKEP duhet te garantoje qe te gjithë operatoret celulare te jene te barabarte apo te kene kapacitete per te krijuar burime te mjaftueshme spektri per te filluar lancimin e sherbimeve nepermjet LTE. Kjo eshte e rendesishme me qellim shmangien e krijimit te avantazheve konkurruese nepermjet kesaj nderhyrje ne treg te autoritetit rregullator, ne favor te disa operatoreve celulare qe nuk perdorin burimet ekzistuese te spektrit qe kane ne zoterim.

Operator 3: eshte shprehur vazhdimisht se ka interes per spektrin e ri persa kohe qe mundesohet rishperndaria e spektrit ekzistues, cka mundeson

vazhdimesine e spektrit per teknologjite e reja qe kerkojne kapacitete me te medha se ne rastin e GSM. Per te krijuar blloqe te vazhdueshme spektri per operatoret, AKEP duhet te kryeje ri-shperndarjen e spektrit ndermjet operatoreve te licensuar per nje brez te caktuar. Vetem pasi te jete kryer rishperndarja, atehere AKEP duhet te procedoje me heqjen e kufizimeve per spektrin ekzistues. Keshtu AKEP do te garantoje barazine ne treg, jo-diskriminim ndaj operatoreve qe do te blejne te drejta perdorimi per spekter te ri dhe do te ofroje atyre garanci ligjore per investimet e kryera afatgjata.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP do te beje te gjitha perpjekjet qe te marre ne konsiderate, propozimet e sipermarresve ne kete keshillim dhe te ofroje zgjidhje qe kenaqin interesat e sa me shume paleve te perfshira, ne perputhje edhe me politikat e sektorit te komunikimeve elektronike.

13- Per pyetjen 13 te AKEP

A jeni dakort me propozimin e AKEP per proceduren e dhenies se Autorizimit?

Operator 1: eshte dakort me perjashtim te brezit fillestar 2x10 MHz qe kerkojme te jepen pa pagese.

Operator 2: Ne jemi dakort me detyrimin e parashtruar ne ligjin per komunikimet elektronike. Per sa i perket Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.1252, date 10.9.2008, ju lutemi t'i referoheni pergjigjes se Pyetjes 14.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP do te vijoje procesin me proceduren e propozuar ne kete keshillim.

14- Per pyetjen 14 te AKEP

Lidhur me piken 10, "Kriteret e Perzgjedhjes", a jeni dakort me propozimin per: Aplikimin e procedures se tenderit publik te percaktuar ne Vendimin Nr.1252, date 10.9.2008?

Operator 1: eshte dakort me perjashtim te brezit fillestar 2x10 MHz qe kerkojme te jepen pa pagese.

Operator 2: Ne pergjithesi, Operator 3 po propozon qe edhe procedura per caktimin e spektrit ne Shgiperi duhet te jete gjithashtu ne linje me parimet standart te parashikuara ne rreguloren e EUT per organizimin e shitjes se spektrit: Se pari, nevoja

qe Autoriteti kombetar te mbaje parasysh trajtimin objektiv, transparent dhe jo-diskriminues ndaj te gjithe operatoreve te perfshire ne proces. Se dyti, procedura e caktimit te frekuencave nuk duhet te keqperdoret per te permiresuar buxhetin e shtetit. Se treti, tarifat nuk duhet te paguhen ne avance, por ne momentin kur operoret te jene te afte te shfrytezojne ne menyre te efektshme spektrin. Keto parime jane aktualisht pjese baze e rregullores se ardhshme "Kontinent i lidhur" te Komisionit European.

Ne lidhje me proceduren e percaktuar ne VKM Nr.1252, date 10.9.2008, te ndryshuar, Kapitullin I, paragrafi 1.1, ne do te propozonim qe agjensia te mos kufizonte caktimin e spektrit si pasoje e situatave te pamjaftueshmerise se kerkeses sesa furnizimi me spekter te lire. Fokusi kryesor i rregullores per caktimin e frekuencave duhet te jete ofrimi i te gjitha burimeve te disponueshme ndaj tregut te komunikimeve elektronike, te cilat nevojiten per te siguruar cilesine e sherbimeve si dhe per te mbeshtetur rritjen, inovacionin dhe implementimin e teknologjive te reja. Pra, caktimi i spektrit pas thirrjes se interesit publik duhet te mundesohet edhe ne rastin kur ka me shume spekter te lire sesa kerkesa per te, lidhur me ate moment ne kohe. Kjo eshte ndryshuar tashme ne Kapitullin III, paragrafet 21.1 dhe 21.2, ne perputhje me Vendimin Nr. 501 te dates 9.06.2010, cka eshte mirepritur.

Persa i perket paragrafit 1.3, duhet te theksojme se ndersa oferta per spekter te lire dhe ngjallja e interesit nga Autoriteti kombetar mund te cojme drejt nje situate me me shume se nje pale te interesuar, atehere duhet te mundesohet edhe caktimi i pjeseve te spektrit per me shume se nje pale te interesuar. Pra, procedura e konkurimit mund te coje ne perzgjedhjen e me shume se nje fituesi te tenderit.

Persa i perket procedurave te pershkruara ne Kapitullin II, paragrafi 1 i vendimit dhe specifikimet parashtruar ne Kapitullin III, paragrafi 4, ne propozojme se perpara caktimit te frekuencave duhet te vendoset edhe nje faze para-kualifikuese. Nje parakusht i rendesishem i vendimeve te suksesshme per caktimin e frekuencave dhe perdorimi efikas dhe i gendrueshem i spektrit eshte nje procedure intensive parakualifikuese qe kerkon vecanerisht pervoje ne hartim dhe mirembajtje rrjeti si dhe ne krijimin e sherbimin (sic parashikohet ne Kapitullin 5.1). Gjithashtu nevojitet qe te sigurohen, sic edhe kerkohet nga vendimi, kapacitetet e mjaftueshme financiare dhe kostot e lancimit. Palet e interesuara qe nuk jane te kualifikuara mjaftueshem mund te cojne ne perdorim jo-efikas te spektrit duke crregulluar keshtu proceduren.

Lidhur me ndryshimin e mundshem te mevone te rregullave dhe kushteve per caktimin e frekuencave, te cilat pershkruhen ne Kapitullin III, paragrafi 6.2, ne propozojme qe te kete nje zgjatje te hapesires kohore prej pese ditesh per dorezimin e ofertave. Nese ndryshimet perfshijne kushte domethenese qe mund te kerkojne rillogaritje dhe procese te reja aprovimi nga ofertuesit e interesuar, atehere minimumi i kohes shtese duhet te jete 10 dite pune.

Persa i perket Kapitullit II, paragrafi 9.1, propozohet qe te hiqet fjalia e fundit per te siguruar nje implikim te parimit baze te transparences dhe paanesise ne rezultatin

dhe fituesit e nje tenderi. Kjo rekomandohet si nje ndryshim i paragrafit 15.8, si alternative e procedures ne grup parashikuar ne dokument. Grupi do te perdorej vetem nese data dhe ora e vules do te ishin identike.

Lidhur me Kapitullin III, paragrafin 10.7 b, ne rekomandojme se ofertuesit duhet te marrin nje mandat qe tregon daten dhe oren e dorezimit te ofertes se tyre. Ne rastin e ofertave me nje shume identike oferte per nje bllok specifik te spektrit, data dhe ora e vules se dorezimit duhet te perdoret si nje baze objektive e vendimit mbi bllokun perkates.

Operator 3: Perserit nevojten imediate per ndryshimin e procesit te ofertimit, perfshire kete proces ofertimi dhe te tjeret ne te ardhmen, per te garantuar efikasitetin maksimal dhe optimizimin e dhenies se spektrit ne perdorim, sipas metodologjive te perqafuara nga eksperiencat me te mira ne BE. Aktualisht, Vendimi 1252/2008 i Keshillit te Ministrave parashikon dhenien e spektrit permes nje procesi ofertimi te vetem tenderi, cka nuk i lejon pjesemarrsit ne tender te ndryshojne oferten e tyre si reagim ndaj ofertave te bera nga pjesetaret e tjere duke konkurruar keshtu ne disa raunde, per te reflektuar ne fund vleren e tregut te spektrit. Ne kete kuader Operator 3 i sugjeron AKEP dhe Ministrit perkates qe te shikohet mundesia e amendimit te VKM 1252/2008 ne menyre qe te reflekoje mundesine per nje tender me disa raunde (jo ne kuptimin qe propozon AKEP, duke krijuar hapesirat per dhenien e disa blloqesh spektri ne te njejten kohe, dhe duke i dhene mundesine ofertuesve te ndryshojne ofertat e tyre ne secilin raund. Zakonisht, ndryshimi i ofertave tenton drejt rritjes, dhe kjo eshte dhe nje mundesi per Qeverine per te maksimizuar te ardhurat e buxhetit te Shtetit nga dhenia e spektrit. Duke marre parasysh praktiken ne vendet Europiane, nje nga formatet me te zakonshme per dhenien e spektrit eshte tenderi me shume raunde te njekohesishme.

Ankandet i mundesojne qeverive te vleresojne ne menyren me te mire nje license duke qene se evidentojne vleren qe ofertuesit i japin licensave dhe se cili eshte ofertuesi qe i vlereson me shume.

Eksperienca tregon se menyra e organizimit te ankandit eshte nje element thelbesor per nje rezultat te sukseshem. Ankandi me i thjeshte eshte ai qe organizohet ne shume raunde njekohesisht (SMRA) me nje cmim fillestar per te garantuar se cmimi i paguar per licensen e rezervuar per nje lojtar te ri nuk eshte ne disproporcion me cmimin e paguar per licensa te tjera. SMRA jane mese te pershtatshem per te arritur nje rezultat eficient nga ana ekonomike, duke qene se ofertuesit marrin informacion gjate kohes se dhenies se ofertes per vlerat e dhena nga pjesemarrsit e tjere dhe mund te pershtasin strategjine e tyre ne kete menyre.

SMRA me nje cmim qe synon rritje duhet te arrije eficence me te madhe ekonomike me perzgjedhjen e operatoreve qe de kene perdorim me te mire te spektrit dhe shpejtesi me te madhe si dhe siguri ne procesin e perzgjedhjes ose alternativisht AKEP mund ti referohet procesit te sukseshem SMRA qe eshte aplikuar

ne Greqi i cili ishte i thjeshte, i shpejte dhe i pershtatet me se miri objektivit per realizimin e nje tenderi efikas multibande.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP do te vijoje proceduren bazuar ne ligjin 9918, i ndryshuar, dhe VKM 1252, e ndryshuar.

15- Per pyetjen 15 te AKEP

Propozimi i AKEP: "Kriteret e Vleresimit": te jene te njejta me ato te aplikuara ne tenderat e meparshem te zhvilluar per kete qellim, pra: - Cmimi i ofertes

Operator 1: eshte dakort me perjashtim te brezit fillestar 2x10 MHz qe kerkojme te jepen pa pagese.

Operator 2: Po, Operator 2 bie dakort me propozimin e AKEP.

Operator 3: Shprehet dakord me propozimin e AKEP.

Qëndrimi i AKEP:

Kriteret e Vleresimit do te jene te njejta me ato te aplikuara ne tenderat e meparshem te zhvilluar per kete qellim, pra cmimi i ofertes.

16- Per pyetjen 16 te AKEP

"Kushti i mbulimit"-mbi kriteret e mbulimit me sherbim ne shkalle gjeografike

Operator 1: Propozon qe mos te kete kerkesa specifike per zonen e mbulimit ne kete brez, sepse ky brez do te perdoret kryesisht per permiresimin indoor dhe te zonave me densitet te larte.

Operator 2: Mendon se nuk duhet te kete detyrime lidhur me nivelin e mbulimit ne te gjithë territorin gjeografik per brezin 2600MHz. Ky mendim argumentohet duke marre ne konsiderate kapacitetet e kufizuara teknologjike ne kete brez te larte frekuencash, i cili nuk lejon penetrimit te thelle te brendshem apo mbulim te gjere te zonave. Spektri 2600MHz eshte hartuar kryesisht per perdorim kapaciteti me shume sesa per perdorim mbulimi. Dhe operatoret e rrjeteve celulare do te perdorin kete spekter aty ku nevojitet te mbulohet kerkesa per me shume trafik, kryesisht ne zonat ku ofrohet.

Operator 3: Gjykon se sherbimi LTE qe synon te ofrohet nepermjet spektrit 2600 MHz nuk do te ofroje nje sherbim te ri ne kuptimin e sherbimeve ekzistuese ne treg (thirrje zanore, SMS, transferim te dhenash me brez te gjere) por do te mundesoje kapacitet me te madh dhe shpejtesi te rritur per transferimin e te dhenave. Ne kete kuptim Operator 3 gjykon qe nuk duhet te ekzistojne detyrime per mbulimin e popullsisë (dhe aq me teper territorit) qe te jene agresive per operatorët ofertues. Sa me tart duhet te jete e aplikueshme per operatorët qe kane tashme rrjet 3 G; nderkohe qe per operatorët e rinj ne treg ose ata operatore qe nuk kane autorizim 3G atehere kriteret e mbulimit duhet te jene te zbatueshme, dhe duhet te njejta me ato qe kane operatorët ekzistues qe kane autorizime 3G.

Sot qe flasim te gjithë operatorët qe ofrojne sherbime GSM dhe UMTS garantojne me mbulim mbi 95% dhe 87% respektivisht te territorit dhe mbi 99% te popullsisë, cka garanton mbulimin e nevojave per sherbimet publike SMS, thirrje zanore dhe transferim te dhenash per publikun e gjere pa qene nevoja qe detyrimet e mbulimit te shtrihen dhe per nje sherbim te avancuar sic eshte LTE. Cdo qendrim i ndryshem do ishte jo-proporcional dhe i pajustificuar perkundrejt investimit te kerkuar e per rrjedhoje do te cenonte ne menyre te konsiderueshme planet financiare te paleve te interesuara dhe vendimmarrjen e operatoreve per blerje spektri dhe per investim. Ketu AKEP duhet patjeter te mbaje ne vemendje dhe veshtiresite e kthimit te investimit per teknologjine LTE e cila per nje pjese te konsiderueshme te popullsisë dhe padiskutim te territorit mund te jete ende premature.

Bazuar ne eksperiencen e vendeve te tjera, dhe tregjet e maturuara me sherbim LTE, perdorimi me i madh i sherbimeve LTE ofruar dhe nepermjet spektrit ne diskutim 2600 MHz, eshte i perqendruar ne zonat urbane me dendesi me te madhe, ose zonat sezonale, sipas nje koncepti 'hotspot' ndryshe nga koncepti i mbulimit te gjere rajonal. Kjo do te thote qe kushtet per mbulim duhet te jene shume me te reduktuara - pa permendur veshtiresite qe ofron ketu terreni i veshtire i Republikes se Shqiperise.

Per sa me lart Operator 3 propozon qe ne rastin me te keq AKEP mund te vendose detyrimin e nje mbulimi progresiv te popullsisë (jo territorit) deri ne 65% brenda nje periudhe 3 vjecare, gjithmone me kushtin qe LTE do te ofrohet midis brezave 1800 MHz dhe 2600 MHz, ku fokusi do te jete ne zonat me popullsi me te ngjeshur dhe zonat sezonale turistike verore ose dimerore. Ne vitet e metejshme (3+) mbulimi ne popullsi mund te shkoje deri ne 80%. Operator 3 shprehet se sherbimi nezonat rurale ose nen-urbane mund te garantohet me mire nepermjet spektrit 800 MHz, ndaj AKEP duhet qe te koordinoje mbulimin e metejshem (mbi 65%) pertej detyrimit 3 vjecar qe ne propozojme me disponibilitetin e spektrit 800 MHz ne funksion te operatoreve celulare'.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP duke marre ne konsiderate edhe propozimet e sipermarresve ne kete keshillim nuk do te aplikojte kritere mbulimi me sherbim gjeografie dhe popullsie per sipermarres zoterues autorizimesh UMTS (ose IMT) por do te aplikojte vetem per sipermarres te rinj.

17- Per pyetjen 17 te AKEP

AKEP mendon qe vlefshmëria e autorizimit të lëshuar të jetë 15 vjet.

Operator 1: eshte dakort me kete propozim.

Operator 2: Edhe pse ligji per komunikimet elektronike e ka te percaktuar se afati i vlefshmerise se Autorizimit duhet te jete 15 vjet, do te donin te sillnim vemendjen tuaj tek diskutimi aktual i draft-rregullores se Komisionit European "Kontinent i Lidhur". Propozimet e Komisionit dhe shumica e ndryshimeve qe vijne nga komiteti drejtues i Parlamentit Evropian te Industrise (ITRE) parashikojne veganerisht nje politike me te harmonizuar te spektrit per Evropën, rrisin spektrin per sherbimet celulare broadband dhe shtrijne afatet per autorizimet perkatese te spektrit ne te pakten 20-30 vjet.

Per me teper, sipas ligjit mbi komunikimet elektronike ne Shqiperi, neni 7/pika 1Objektivat RREGULLATORE:

1. AKEP ushtron funksionet ne perputhje me kete ligj dhe me aktet e tjera ligjore, si dhe ne perputhje me politikat sektoriale kombetare te zhvillimit te komunikimeve elektronike dhe me marreveshjet nderkombetare ne fushen e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqiperise eshte pale. AKEP merr ne konsiderate rekomandimet dhe vendimet e Komisionit Evropian dhe BEREC".

Operator 3: Persa i takon kohezgjatjes se disponibilitetit te autorizimit Operator 3 shprehet dakord qe minimumi i afatit te autorizimit te jete 15 vjet, por gjykon qe operatorit fitues duhet ti garantohet nje rinovim i afatit minimalisht 5 vjecar, pra nje kohezgjatje autorizimi 15+5 vjet me te drejte rinovimi. Kjo eshte ne funksion te mbrojtjes se investimit dhe pamundesise se rikthimit te tij brenda nje kohe relativisht te shkurter pare ne kendveshtrimin e tregut shqiptar.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP do te aplikojte afat vlefshmerie autorizimi prej 15 vjetesh.